



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1046/8 prot.

Datë 21.05.2026

V E N D I M

Nr. 683/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro
Anila Malaj
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Anëtar
Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.05.2026 u shqyrtua ankesa me

Objekt:

Anulimi i anulimit të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “*Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm*”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara si dhe kualifikimi i shoqërisë “BionicTech” SHPK.

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

Ankimues:

Operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, me NUIS M41406021N, me adresë: Rr. Stavri Themeli, ZK 8220, vol.12, fq.23 me nr. Pasurie 8/307-N2, Tiranë

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për*

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në procedurën e mësipërme të prokurimit ka marrë pjesë vetëm ofertuesi ankimues.

II.3. Në datën 01.04.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.4. Në datën 07.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6488, protokolluar me nr. 1046/2026 protokolli, datë 07.04.2026, e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit *“Procedurë e hapur, e thjeshtuar”*, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt *“Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”*, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe skualifikimin e shoqërisë ankimuese.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Ne date 18.03.2026 jemi njohur me publikimin e procedures Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm. . Ne date 30.03.2026 kemi dorezuar oferten tone ne sistemin e APP. Ne date 01.04.2026 jemi njohur me vendimin e Autoriteti kontraktor per anulimin e procedures me arsyetimin ne procedurat me nje faze nuk eshte paraqitur asnje oferte e vlefshme. Janë cenuar rëndë: parimet bazë të prokurimit publik të drejtën për konkurrencë të ndershme të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Shkelje e Nenit 2 Parimet themelore Sipas nenit 2 të Ligji nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor është i detyruar të respektojë: transparencën trajtimin e barabartë konkurrencën Në këtë rast: Transparenca mungon (pa raport vlerësimi) Barazia është cenuar (oferta jonë nuk është trajtuar).Konkurrenca është eliminuar (procedura u anulua pa analizë). shkelje e Nenit 82 Vlerësimi i ofertave Ligji përcakton qartë: Vlerësimi i ofertave është fazë e detyrueshme e procedurës Autoriteti Kontraktor: nuk ka kryer vlerësim teknik nuk ka kryer vlerësim ekonomik nuk ka dokumentuar analizë. Kjo e bën vendimin: proceduralisht të pavlefshëm në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin.Shkelje e Nenit 86 Skualifikimi i operatorëve. Një operator mund të skualifikohet vetëm nëse: identifikohen shkelje konkrete arsyetimi është i dokumentuar vendimi është i motivuar. Në këtë rast: Nuk ka asnjë akt skualifikimi Nuk ka arsyetim Nuk ka referencë ndaj DST Pra, nuk ekziston juridikisht ofertë e pavlefshme . Shkelje e Nenit 98 Anulimi i procedurës Ligji lejon anulimin vetëm kur: nuk ka oferta të vlefshme PAS vlerësimit. Në këtë rast: nuk ka vlerësim nuk ka analizë nuk ka dokumentim Për rrjedhojë: Anulimi është i paligjshëm Vendimi është arbitrar.utoriteti Kontraktor ka bërë një devijim total nga procedura ligjore: Ka anuluar procedurën Pa kryer vlerësim Pa provuar pavlefshmëri Pa arsyetim Kjo përbën: tejkalim kompetence shkelje të rëndë procedurale cenim të drejtpërdrejtë të konkurrencës . Kërkojmë: Shfuqizimin e vendimit për anulimin e procedurës Konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Kontraktor Rikthimin e procedurës në fazën e vlerësimit të ofertave Detyrimin e Autoritetit Kontraktor për: kryerjen e vlerësimit sipas ligjit dokumentimin e procesit publikimin e arsyetimit. Kualifikimin e ofertes sone si oferte e vlefshme.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për

procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1046/1 Prot., datë 08.04.2026.

II.6. Në datën 14.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 1046/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1262/8 prot., datë 09.04.2026 me objekt: *“Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK, lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr.Ref-79387-03-17-2026, me objekt: “Loti 4 “Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm””, bashkëngjitur vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave K.SH.A.56/2026, datë 09.04.2026.*

Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr. 56/2026, datë 09.04.2026 rezulton se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK.

II.7. Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve KPP konstatoi se procedura e mësipërme e prokurimit është hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, ndaj dhe, nëpërmjet shkresës nr. 1046/3 prot., datë 30.04.2026 me objekt: *“Kërkesë për kthim procedure në SPE”*, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor si vijon:

“Në datën 07.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6488, protokolluar me nr. 1046/2026 protokoli, datë 07.04.2026, e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe skualifikimin e shoqërisë ankimuese.

Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se procedura e mësipërme e prokurimit është hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.”

II.8. Në datën 07.05.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1046/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1262/17 prot., datë 05.05.2026 me objekt: *“Mbi kthimin në SPE të procedurës së prokurimit REF-79387-03-17-2026 me objekt: “Loti 4 Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”.* Me anë të kësaj shkrese autoriteti

kontraktor informon KPP-në se, në përgjigje të kërkesës për kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të APP-së, procedura e prokurimit në fjalë është hequr nga statusi “Procedura të anuluar” dhe është rikthyer në statusin “Procedura të publikuara”.

II.9. Me shkresën nr. 1046/5 prot., datë 18.05.2026 me objekt: *“Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative”* si dhe Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi zhvillimin e një seance dëgjimore ditën e enjte, datë 21.05.2026 ora 11:00, në mjediset e institucionit të KPP-së me përfaqësues të KVO-se të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, të cilët disponojnë të dhënat për tu futur në llogarinë përkatese në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.10. Në datën 21.05.2026, ora 11.00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt senca dëgjimore me përfaqësues të KPP-së, të autoritetit kontraktor në rolin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK. Në prani të të gjitha palëve, u logua në SPE përfaqësuesi i operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK nga ku rezultoi se nga ky i fundit nuk është marrë dijeni për vlerësimin përfundimtar të ofertave dhe arsyet konkrete të skualifikimit të tij. Pra pas hapjes së llogarisë së përdoruesit rezultoi, se në rubrikën “Mesazhe” të subjektit në fjalë nuk pasqyrohen njoftimet e vlerësimit dhe arsyet e skualifikimit.

Gjithashtu rezultoi se procedura e mësipërme e prokurimit, me fazat përkatese, nuk është rikthyer në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK, se: *“Ne date 18.03.2026 jemi njohur me publikimin e procedures Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje*

laboratori me prodhues të ndryshëm. Ne date 30.03.2026 kemi dorezuar oferten tone ne sistemin e APP. Ne date 01.04.2026 jemi njohur me vendimin e Autoriteti kontraktor per anullimin e procedures me arsyetimin ne procedurat me nje faze nuk eshte paraqitur asnje oferte e vlefshme. Janë cenuar rëndë: parimet bazë të prokurimit publik të drejtën për konkurrencë të ndershme të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Shkelje e Nenit 2 Parimet themelore Sipas nenit 2 të Ligji nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktor është i detyruar të respektojë: transparencën trajtimin e barabartë konkurrencën Në këtë rast: Transparenca mungon (pa raport vlerësimi) Barazia është cenuar (oferta jonë nuk është trajtuar).Konkurrenca është eliminuar (procedura u anulua pa analizë). shkelje e Nenit 82 Vlerësimi i ofertave Ligji përcakton qartë: Vlerësimi i ofertave është fazë e detyrueshme e procedurës Autoriteti Kontraktor: nuk ka kryer vlerësim teknik nuk ka kryer vlerësim ekonomik nuk ka dokumentuar analizë. Kjo e bën vendimin: proceduralisht të pavlefshëm në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ligjin.Shkelje e Nenit 86 Skualifikimi i operatorëve. Një operator mund të skualifikohet vetëm nëse: identifikohen shkelje konkrete arsyetimi është i dokumentuar vendimi është i motivuar. Në këtë rast: Nuk ka asnjë akt skualifikimi Nuk ka arsyetim Nuk ka referencë ndaj DST Pra, nuk ekziston juridikisht ofertë e pavlefshme . Shkelje e Nenit 98 Anulimi i procedurës Ligji lejon anulimin vetëm kur: nuk ka oferta të vlefshme PAS vlerësimit. Në këtë rast: nuk ka vlerësim nuk ka analizë nuk ka dokumentim Për rrjedhojë: Anulimi është i paligjshëm Vendimi është arbitrar.utoriteti Kontraktor ka bërë një devijim total nga procedura ligjore: Ka anuluar procedurën Pa kryer vlerësim Pa provuar pavlefshmëri Pa arsyetim Kjo përbën: tejkalim kompetence shkelje të rëndë procedurale cenim të drejtpërdrejtë të konkurrencës . Kërkojmë: Shfuqizimin e vendimit për anulimin e procedurës Konstatimin e paligjshmërisë së veprimeve të Autoritetit Kontraktor Rikthimin e procedurës në fazën e vlerësimit të ofertave Detyrimin e Autoritetit Kontraktor për: kryerjen e vlerësimit sipas ligjit dokumentimin e procesit publikimin e arsyetimit. Kualifikimin e ofertes sone si oferte e vlefshme”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 18.03.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

III.1.2. Në procedurën e mësipërme të prokurimit ka marrë pjesë vetëm ofertuesi ankimues.

III.1.3. Në datën 01.04.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.4. Në datën 07.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6488, protokolluar me nr. 1046/2026 protokolli, datë 07.04.2026, e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet

me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe skualifikimin e shoqërisë ankimuese si më sipër cituar.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 1046/1 Prot., datë 08.04.2026.

III.1.6. Në datën 14.04.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me 1046/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1262/8 prot., datë 09.04.2026 me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK lidhur me vlerësimin , në procedurën e prokurimit me nr.Ref-79387-03-17-2026, me objekt: “Loti 4 “Shërbime mirëmbajtje për pajisje laboratory me prodhues të ndryshëm””, bashkëngjitur vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave K.SH.A. 56/2026, datë 09.04.2026. Referuar Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave Nr. 56/2026, datë 09.04.2026 rezulton se ky i fundit ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK.

III.1.7. Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve KPP konstatoi se procedura e mësipërme e prokurimit është hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, ndaj dhe, nëpërmjet shkresës nr. 1046/3 prot., datë 30.04.2026 me objekt: “Kërkesë për kthim procedure në SPE”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor si vijon: “Në datën 07.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6488, protokolluar me nr. 1046/2026 protokoli, datë 07.04.2026, e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe skualifikimin e shoqërisë ankimuese. Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se procedura e mësipërme e prokurimit është hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.”

III.1.8. Në datën 07.05.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1046/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 1262/17 prot., datë 05.05.2026 me objekt: *“Mbi kthimin në SPE të procedurës së prokurimit REF-79387-03-17-2026 me objekt: “Loti 4 Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”*. Me anë të kësaj shkrese autoriteti kontraktor informon KPP-në se në përgjigje të kërkesës për kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të APP-së, procedura e prokurimit në fjalë është hequr nga statusi “Procedura të anuluar” dhe është rikthyer në statusin “Procedura të publikuara”.

III.1.9. Me shkresën nr. 1046/5 prot., datë 18.05.2026 me objekt: *“Njoftim për seancë dëgjimore pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK, dhe me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” si dhe Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik kërkoi zhvillimin e një seance dëgjimore ditën e enjte, datë 21.05.2026 ora 11:00, në mjediset e institucionit të KPP-së me përfaqësues të KVO-së të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik, të cilët disponojnë të dhënat për tu futur në llogarinë përkatëse në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

III.1.10. Në datën 21.05.2026, ora 11.00 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u mbajt senca dëgjimore me përfaqësues të KPP-së, të autoritetit kontraktor në rolin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK. Në prani të të gjitha palëve, u logua në SPE përfaqësuesi i operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK nga ku rezultoi se nga ky i fundit nuk është marrë dijeni për vlerësimin përfundimtar të ofertave dhe arsyet konkrete të skualifikimit të tij. Pra pas hapjes së llogarisë së përdoruesit rezulton, se në rubrikën “Mesazhe” të subjektit në fjalë nuk pasqyrohen njoftimet e vlerësimit dhe arsyet e skualifikimit. Gjithashtu rezultoi se procedura e mësipërme e prokurimit, me fazat përkatëse, nuk është rikthyer në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

III.1.11. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 *“Për prokurimin publik”* parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.12. Në nenin 3 Parime të përgjithshme: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën.*

Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.13. Në nenin 80 pika 1,2,3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.

2. Autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin refuzimin e ofertës, pavarësisht vlerës së saj, nëse vlerësohet se oferta e paraqitur nuk është në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit vendas, marrëveshjeve ndërkombëtare ose legjislacionit vendas në fushën e mjedisit, mbrojtjes shoqërore dhe punës.

3. Autoritetet ose entet kontraktore i shqyrtojnë ofertat e paraqitura bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët ekonomikë dhe legjislacionin përkatës në fuqi.”

III.1.14. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.15. Në udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, parashikohet shprehimisht se:

“Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.”

III.1.16. KPP gjykon, se operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produktet e ofruara garantojnë realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.1.17. Nisur nga sa më sipër rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk ka marrë dijeni nëpërmjet SPE mbi arsyet konkrete të skualifikimit të tij, duke e vënë në pozita të paqarta dhe konfuze shoqërinë “BionicTech” SHPK si dhe në pamundësi për të argumentuar apo kundërshtuar skualifikimin e tij nga ana e KVO-së. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të rikthejë procedurën e prokurimit objekt ankimi, në statusin e fazës së vlerësimit ku secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave duhet të evidentojë qartë dhe saktë, se cilat janë parregullsitë konkrete të konstatuara në ofertën e operatorit ekonomik “BionicTech” SHPK. Në përputhje me Udhëzimin nr. 01, datë 03.06.2025 “Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, të Agjencisë së Prokurimit Publik, pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem dhe në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës. Më pas autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit, bazuar në ligjin e prokurimit publik, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “BionicTech” SHPK qëndrojnë pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BionicTech” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-79387-03-17-2026 me objekt “Loti 4: Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond limit 2,281,543.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 30.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke rikthyer procedurën e prokurimit objekt ankimi, në statusin e fazës së vlerësimit dhe të vijojë me hapat e mëtejshme të saj në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “BionicTech” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi, i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

